



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT, MJEDISIT DHE PRONËS
SEKTORI I MJEDISIT DHE SHËRBIMEVE ME SIPËRMARRJE

Nr. 5044/12 / prot.

Gramsh, më 21/11/2025

Relacion

“Për përballimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Xhevair Sefendin Qyra”.

Mbështetur në Ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, në ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe kërkesës të paraqitur nga z. Andrea Benishta datë 17.11.2025 protokolluar me tonën nr.5044/1 prot, datë 17.11.2025, i cili parashtrohet sa më poshtë vijon:

Në datën 09.11.2025 është gjendur i pajetë në rrugë nga policia i ndieri **Xhevair Sefendin Qyra** me vendbanim në Nj.Administrative Kodovjat, fshati Broshtan. Duke qënë se u konstatua se i ndjeri nuk kishte krijuar familje dhe nuk kishte asnjë të afërm që të merrte përsipër shpenzimet e tij të varrimit, është autorizuar nga Bashkia Gramsh agjensia funerale e përfaqësuar nga z.Andrea Benishta të kryente të gjitha procedurat e varrimit të të ndjerit. Bashkëlidhur kërkesa Nr.5044/1 Prot., datë 17.11.2025, si dhe dokumentacioni vijues:

1. Çertifikata Personale e të ndjerit Xhevair Sefendin Qyra
2. Çertifikata Familjare e të ndjerit Xhevair Sefendin Qyra.
3. Leje Varrimi nga Zyra e Gjëndjes Civile Gramsh
4. Fatura e shërbimit funeral nr. 47 datë 09.11.2025.
5. Autorizimi nr. 5044 datë 17.11.2025

Në këto kushte i propozojmë këshillit të bashkisë që t'i kompesojë shpenzimet e varrimit agjensisë së shërbimit funeral të z.Andrea Benishta në shumën prej 90500 lekë, të cilat përballohen nga buxheti i vitit 2025 të bashkisë Gramsh.

KRYETARI
Besion AJAZI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr. 5044/prot



Gramsh, më 21 / 11 / 2025

P/Vendim

Për përballimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Xhevair Sefendin Qyra.

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës ____/____/2025, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga drejtoria e Planifikimit të territorit, mjedisit dhe pronës. "Për përballimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Xhevair Sefendin Qyra", në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, pika 2;

Vendosi:

- I. Bashkia Gramsh të përballojë nga buxheti i vitit 2025, shpenzimet e varrimit të ndjerit Xhevair Sefendin Qyra.
- II. Shpërblimi i varrimit në shumën 90.500 lekë ti jepet shërbimit funeral të z. Andrea Benishta.
- III. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës.
- IV. Për sa më sipër të bëhen ndryshimet në buxhet si më poshtë:

Enti Qevesise s	Min. Linje s	Kodi. Institucioni	Ermërtimi Institucionit	Kapitulli	Programe	Llog. Ekono	TDO	Debiti
			Pakësohet					
114	00	2114001	Bashkia Gramsh	05	04980	6090000	0810	90.500
			Shtohet					
114	00	2114001	Bashkia Gramsh	05	01110	6060000	0810	90.500

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI KËSHILLIT
XHULIA GJINI

KRYETARI I KËSHILLIT
ENIS ZANI

Adresa: Sheshi "Kamber Dermysi" Bulevard "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 Email:bashkia.gramsh@bashkiagramsh.gov.al